



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite - Ministry of Labour and Social Welfare.*

---

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MPMS) Nr. 04/2020  
PËR RREGULLIMIN DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR  
REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE SINDIKALE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MLSW) No. 04/2020  
FOR REGULATION AND DETERMINATION OF CRITERIA AND PROCEDURES FOR  
REGISTRATION OF TRADE UNION ORGANIZATIONS**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MRSZ) Br. 04/2020  
O UREĐENJU I ODREĐIVANJU KRITERIJUMA I POSTUPAKA ZA REGISTRACIJU SINDIKALNIH  
ORGANIZACIJA**

<p><b>Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale,</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 32 të Ligjit nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.11/2011 të dt.26.08.2011), duke u bazuar në nenin 8, paragrafin 1.4 të Rregullores nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020), Nr. 07/2020, Shtojcën 12 dhe nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë (GZ, nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerr:</p> <p><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPMS) Nr. 04/2020 PËR RREGULLIMIN DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE SINDIKALE</b></p>	<p><b>Minister of Labor and Social Welfare,</b></p> <p>Pursuant to Article 32 of Law no. 04 / L-011 on Trade Union Organization in Kosovo, (Official Gazette of the Republic of Kosovo no. 11/2011 dated 26.08.2011), based on Article 8, paragraph 1.4 of Regulation no. 06/2020 on Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (08.06.2020), no. 07/2020, Annex 12 and Article 38, paragraph 6 of Regulation no. 09/2011 on the Work of the Government (GZ, no.15, 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MPMS) No. 04/ 2020 FOR REGULATION AND DETERMINATION OF CRITERIA AND PROCEDURES FOR REGISTRATION OF TRADE UNION ORGANIZATIONS</b></p>	<p><b>Ministar Rada i Socijalne Zaštite,</b></p> <p>Na osnovu člana 32. Zakona br. 04 / L-011 o Sindikalnoj Organizaciji na Kosovu, (Službeni list Republike Kosovo br. 11/2011 od 26.08.2011), na osnovu člana 8, stav 1.4 Uredbe br. 06/2020 o Oblastima Administrativne Odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava (08.06.2020), br. 07/2020, Aneks 12 i član 38, stav 6 Poalovnika br. 09/2011 o Radu Vlade (Sl, br. 15, 12.09.2011.),</p> <p>Izdaje:</p> <p><b>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MPMS) br. 04/2020 O UREĐENJU I ODREĐIVANJUKRITERIJUMA I POSTUPAKA ZA REGISTRACIJU SINDIKALNIH ORGANIZACIJA</b></p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e kushteve dhe kritereve që duhet t'i plotësojnë organizatat sindikale për t'u regjistruar dhe funksionuar pas regjistrimit si dhe përcaktimin e procedurave për regjistrimin apo ç' regjistrimin e tyre nga organi përgjegjës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>This Administrative Instruction aims to regulate the conditions and criteria that must be met by trade union organizations to register and operate after registration and determine the procedures for their registration or deregistration by the responsible body of the Ministry of Labor and Welfare Social (MLSW).</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 1 Svrha</b></p> <p>Ovo administrativno Uputstvo ima za cilj da reguliše uslove, kriterijume koje sindikalne organizacije trebaju da ispune da bi se registrovali i da funkcionisu nakon upisa kao i određivanje postupaka za njihovu registraciju ili ispisa od strane odgovornog tela Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite (MRSZ).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 2 Fushëveprimi</b></p> <p>1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet tek organizatat sindikale të cilat aplikojnë për regjistrim në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.</p> <p>2. Departamenti përkatës i Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është organ përgjegjës për zbatimin e kushteve dhe kritereve për regjistrimin e organizatave sindikale.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 2 Scope</b></p> <p>1. This Administrative Instruction applies to trade union organizations which apply for registration with the Ministry of Labor and Social Welfare.</p> <p>2. The relevant Department of Labor in the Ministry of Labor and Social Welfare, is the body responsible for implementing the conditions and criteria for registration of trade unions.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 2 Obim</b></p> <p>1. Ovo Administrativno Uputstvo primenjuje se na sindikalne organizacije koje apliciraju za registraciju u Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite .</p> <p>2. Relevantni Departman Rada Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite je telo odgovorno za sprovođenje uslova i kriterijuma za upis sindikata.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, kanë kuptimin e njëjtë sikurse shprehjet e përdorura në Ligjin nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. All expressions used in this Administrative Instruction, have the same meaning as the expressions used in Law no. 04 / L-011 on Trade Union Organization in Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Svi izrazi korišćeni u ovom Administrativnom Uputstvu imaju isto značenje kao izrazi korišćeni u Zakonu br. 04 / Z-011, o Sindikalnom Organizovanju na Kosovu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Kriteret për regjistrimin e organizatave sindikale</b></p> <p>1. Organizatat sindikale si shoqata, federata dhe konfederata sindikale, për zyrtarizimin e fushëveprimit të tyre, duhet të aplikojnë për regjistrim në organin përgjegjës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.</p> <p>2. Shoqata sindikale, si njësi themelore organizative e organizimit sindikal, regjistrohet në MPMS, nëse ka së paku dhjetë (10) anëtarë sindikal të anëtarësuar në mënyrë vullnetare në të e cila zhvillon veprimtarinë si e pavarur nga ndonjë Federatë sindikale.</p> <p>3. Federata sindikale, regjistrohet në MPMS, nëse në kuadër të saj ka së paku dy</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4 Criteria for registration of trade unions</b></p> <p>1. Trade unions (associations, federations and trade union confederations) to formalize their scope, must apply for registration in the responsible body of the Ministry of Labor and Social Welfare.</p> <p>2. The trade union association, as the basic organizational unit of the trade union organization, is registered in MLSW, if there are at least ten (10) union members voluntarily joined in which it operates as independent from any trade union federation.</p> <p>3. The trade union federation is registered in MLSW, if within it there are at least two</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4 Kriterijumi za registraciju sindikata</b></p> <p>1. Sindikati (udruženja, federacije i sindikalne konfederacije) da bi formalizovali svoj delokrug treba se prijaviti za registraciju u odgovornom telu Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite.</p> <p>2. Sindikalno Udruženje, kao osnovna organizaciona jedinica sindikalne organizacije, može se registrovati u MRSZ, ako u njemu postoji najmanje 10 (deset) dobrovoljnih članova sindikata u kojoj posluje nezavisno od bilo koje sindikalne federacije.</p> <p>3. Sindikalna federacija se registruje u MRSZ, ukoliko u njoj postoje najmanje 2</p>

<p>(2) shoqata sindikale të veprimtarisë së njëjtë ose të ngjashme, të regjistruara më parë në MPMS, anëtarësia e të cilave është së paku 10% e të punësuarve në sektorin përkatës. Federata sindikale e regjistruar në MPMS, mund të pranoj shoqata sindikale në përberjen e vetë, por duhet të jenë të veprimtarisë së njëjtë ose të ngjashme.</p> <p>4. Konfederata sindikale, regjistrohet në MPMS, nëse në kuadër të saj veprojnë së paku dy (2) federata sindikale të veprimtarive të ndryshme, të regjistruara më parë në MPMS, anëtarësia e të cilave është së paku 10% e të punësuarve në nivel vendi.</p> <p>5. Organizatat sindikale zhvillojnë aktivitetin e vet, vetëm pasi të jenë regjistruar në MPMS.</p> <p>6. Personi udhëheqës i organizatave sindikale shoqatës, federatës apo Konfederatës, duhet të parashtrij deklaratë me shkrim, se nuk është i zgjedhur apo i emëruar në pozita udhëheqëse menaxheriale, nuk është pjesë e strukturave udhëheqëse në parti politike, apo ndonjë formë tjetër e organizimit e cila mund të konsiderohet konflikt interesi.</p>	<p>(2) trade unions of the same or similar activity, previously registered in MLSW, whose membership is at least 10% of the employees in the sector concerned. The trade union federation registered in MLSW may accept trade unions in its own composition, but they must be of the same or similar activity.</p> <p>4. Trade union confederation can be registered in MLSW, if within it operate at least 2 (two) trade union federations of different activities, previously registered in MLSW, whose membership is at least 10% of employees in level country.</p> <p>5. Trade unions can start and develop their activity only after being registered in MLSW.</p> <p>6. The leader person of the trade union organizations of the association, federation or confederation, must submit a written statement, that he is not elected or appointed to managerial managerial positions, is not part of the leading structures in political parties, or any other form of organization which may be considered a conflict of interest.</p>	<p>(dva) udružena sindikata iste ili slične delatnosti, prethodno registrovani u MRSZ, čije članstvo čini najmanje 10% zaposleni u odgovarajućem sektoru. Sindikalna federacija registrovana u MRSZ može da prihvati sindikate u svom sastavu, ali oni trebaju biti iste ili slične delatnosti.</p> <p>4. Sindikalna konfederacija može biti registrovana u MRSZ, ako u okviru nje deluju najmanje 2 (dve) sindikalne federacije različitih delatnosti, prethodno registrovane u MRSZ, čije je članstvo najmanje 10% zaposlenih u nivo zemlje.</p> <p>5. Sindikalne Organizacije mogu započeti i razvijati svoje aktivnosti tek nakon što se registruju u MRSZ.</p> <p>6. Rukovodioc sindikalnih organizacija udruženja, federacije ili konfederacije mora podneti pismenu izjavu da nije izabran ili imenovan na rukovodeće rukovodeće položaje, nije deo vodećih struktura u političkim strankama ili bilo koji drugi oblik organizacije koji može smatrati sukobom interesa .</p>
---	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e shoqatave sindikale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Necessary documentation for registration of trade unions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Neophodna dokumentacija za registraciju udruženih sindikala</b></p>
<p>1. Shoqata sindikale me rastin e aplikimit për t'u regjistruar në MPMS, krahas kërkesës me shkrim, duhet të prezantojë edhe këtë dokumentacion:</p> <p>1.1. Statutin e shoqatës;</p> <p>1.2. Procesverbalin e mbledhjes konstituive të shoqatës;</p> <p>1.3. Dokumentin për emërtimin e shoqatës, i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me shoqatat e regjistruara më parë në MPMS apo me ndonjë shoqatë sindikale në përberje të Federatës, selinë dhe logon e shoqatës;</p> <p>1.4. Regjistrin e të gjithë anëtarëve të shoqatës, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, nënshkrimet dhe adresat e anëtarëve sindikal;</p> <p>1.5. Deklaratat për anëtarësim të të gjithë anëtarëve sindikal në shoqatë; dhe</p>	<p>1. The trade union on the occasion of the application to register in MLSW, in addition to the written request, must also present this documentation:</p> <p>1.1. Statute of the association;</p> <p>1.2. Minutes of the constitutive meeting of the association;</p> <p>1.3. The document for the name of the association, which should not be the same as the associations previously registered in MLSW or with any trade union association within the Federation, the headquarters and the logo of the association;</p> <p>1.4. Register of all members of the association, including name and surname, birthday, ID number, signatures and addresses of union members;</p> <p>1.5. Statements for membership of all union members in the association; and</p>	<p>1. Sindikalno udruženje, prilikom apliciranja za registraciju u MRSZ, pored pismenog zahteva, mora da priloži i ovu dokumentaciju:</p> <p>1.1. Statut udruženja;</p> <p>1.2. Zapisnik konstitutivnog sastanka udruženja;</p> <p>1.3. Dokument za naziv udruženja, kojine bi trebalo da bude isti kao udruženja koja su prethodno registrovana u MRSZ, ili sa bilo kojim sindikalnim udruženjem u Federaciji sedište i logotip udruženja;</p> <p>1.4. Registar svih članova udruženja, uključujući ime i prezime, rođendan, matični broj, potpise i adrese članova sindikala ;</p> <p>1.5. Izjave o članstvu svih članova sindikala u udruženju; i</p>

<p>1.6. Të dhënat e sakta për udhëheqjen sindikale, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, telefonit dhe nënshkrimet e anëtarëve të udhëheqjes sindikale.</p> <p>2. Anëtar i një shoqate sindikale nuk mund të jetë edhe anëtar i një shoqate tjetër sindikale.</p> <p>3. Ministria në raste të caktuara, benë verifikimin e deklaratave të anëtarëve sindikal gjatë aplikimit.</p> <p>4. Në rast se ekziston një shoqatë sindikale e regjistruar më parë në MPMS, apo në federatë sindikale të regjistruar në MPMS nga e njëjta organizatë, shoqata që aplikon për regjistrim duhet të prezantojë deklaratat për ç'anëtarësim të anëtarëve që kanë qenë anëtarë në shoqatën paraprake dhe deklaratat për anëtarësim në shoqatën e re.</p>	<p>1.6. Accurate data on union leadership, including first and last name, birthday, ID number, telephone and signatures of union leadership members;</p> <p>2. A member of a trade union association cannot be a member of another trade union association.</p> <p>3.The Ministry in certain cases, do the verification of the statements of the union members during the application.</p> <p>4. In case if there exist the a trade union association previously registered in MLSW, or in a trade union federation registered in MLSW by the same organization, the association applying for registration must submit declarations for de-membership of members who were members of the previous association and statements for membership in the new association.</p>	<p>1.6. Tačni podaci o rukovodstvu sindikala, uključujući ime i prezime, rođendan, matični broj, telefon i potpise članova rukovodstva sindikata;</p> <p>2. Član jednog sindikalnog udruženja ne može biti član drugog sindikalnog udruženja;</p> <p>3. Ministarstvo u određenim slučajevima obavlja verifikaciju izjava članova sindikala tokom apliciranja .</p> <p>4. Ako postoji jedno udruženje koje je prethodno registrovano u MRSZ ili sindikalnoj federaciji u MRSZ od iste organizacije , udruženje koje se prijavljuje za registraciju mora podneti izjave o nečlanstvu članova koji su bili članovi prethodnog udruženja i izjave o članstvu u novom udruženju.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e federatës sindikale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Necessary documentation for the registration of the trade union federation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Neophodna dokumentacija za registraciju Sindikalnog Saveza</b></p>
<p>1. Federata sindikale me rastin e aplikimit për t'u regjistruar në MPMS, krahas kërkesës me shkrim, duhet të prezantojë edhe këtë dokumentacion:</p> <p>1.1.Statutin e federatës;</p> <p>1.2.Procesverbalin e mbledhjes konstituive të federatës;</p> <p>1.3.Regjistrin e të gjithë anëtarëve sindikal të federatës, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, nënshkrimet dhe adresat e anëtarëve sindikal;</p> <p>1.4.Dokumentin për emërtimin e federatës, i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me federatat sindikale të regjistruara më parë në MPMS, selinë dhe logon e federatës;</p> <p>1.5.Dokumentin për numrin dhe përqindjen e anëtarëve sindikal të</p>	<p>1. The trade union federation on the occasion of the application to register in MLSW, in addition to the written request, must also present this documentation:</p> <p>1.1. Statute of the federation;</p> <p>1.2. Minutes of the constitutive meeting of the federation;</p> <p>1.3. Register of all union members of the federation, including name and surname, birthday, ID number, signatures and addresses of union members;</p> <p>1.4. The document for the name of the federation, which should not be the same as the trade union federations previously registered in MLSW, the headquarters and the logo of the federation;</p> <p>1.5. Document on the number and percentage of trade union members of</p>	<p>1. Sindikalna federacija povodom zahteva za registraciju u MRSZ, pored pismenog zahteva, mora da priloži i sledeću dokumentaciju:</p> <p>1.1. Statut Federacije;</p> <p>1.2. Zapisnik konstitutivnog sastanka federacije;</p> <p>1.3. Registar svih članova saveza Federacije, uključujući ime i prezime, rođendan, matični broj, potpise i adrese članova sindikata;</p> <p>1.4. Dokument za naziv federacije, koji ne bi trebalo da bude isti kao Sindikalna federacija koji su prethodno bili registrovani u MRSZ, sedišta i logotip federacije;</p> <p>1.5. Dokument o broju i procentu članova sindikata udruženih u sindikat;</p>



<p>shoqatave sindikale të bashkuara në federatë sindikale;</p> <p>1.6. Deklaratat për anëtarësim të anëtarëve sindikal në federatë;</p> <p>1.7. Të dhënat e sakta për udhëheqjen e federatës sindikale, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, telefonit dhe nënshkrimet e anëtarëve të udhëheqjes sindikale;</p> <p>1.8. Vendimin për bashkimin e shoqatave sindikale në federatë sindikale.</p> <p>2. Anëtari i një federate sindikale nuk mund të jetë edhe anëtar i një federate tjetër sindikale.</p> <p>3. Në rast se ekziston një federatë e regjistruar më parë nga e njëjta organizatë apo sektor, federata që aplikon për regjistrim duhet të prezantojë deklaratat për ç'anëtarësim të anëtarëve që kanë qenë anëtarë në federatën paraprake dhe deklaratat për anëtarësim në federatën e re.</p>	<p>trade unions united in a trade union federation;</p> <p>1.6. Declarations for membership of trade union members in the federation;</p> <p>1.7. Accurate data on the leadership of the trade union federation, including name and surname, birthday, ID number, telephone number and signatures of the members of the trade union leadership;</p> <p>1.8. The decision to unite the trade unions in the trade union federation.</p> <p>2. A member of a trade union federation may not be a member of another trade union federation.</p> <p>3. If there is a federation previously registered by the same organization or sector, the federation applying for registration must submit the disqualification declarations of the members who were members of the previous federation and the declarations of membership in the new federation.</p>	<p>1.6. Izjave o članstvu članova sindikata u federaciji;</p> <p>1.7. Tačni podaci o rukovodstvu sindikalne federacije, uključujući ime i prezime, rođendan, matični broj ID karte, broj telefona i potpise članova sindikalnog rukovodstva;</p> <p>1.8. Odluka o sjedinjenju sindikalnih udruženja u sindikalnoj federaciji.</p> <p>2. Član jedne sindikalne federacije ne može biti član druge sindikalne federacije.</p> <p>3. U slučaju da postoji jedna federacija prethodno registrovana od iste organizacije ili sektora, federacija koja se prijavljuje za registraciju mora podneti izjave o diskvalifikaciji članova koji su bili članovi prethodne federacije i izjave o članstvu u novoj federaciji.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e konfederatës sindikale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Necessary documentation for the registration of the trade union confederation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Neophodna dokumentacija za registraciju Sindikalne Konfederacije</b></p>
<p>1. Konfederata sindikale me rastin e aplikimit për t'u regjistruar në MPMS, krahas kërkesës me shkrim, duhet të prezantojë edhe këtë dokumentacion:</p> <p>1.1. Statutin e konfederatës;</p> <p>1.2. Procesverbalin e mbledhjes së kongresit të konfederatës;</p> <p>1.3. Regjistrin e të gjithë anëtarëve aktual të konfederatës, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, nënshkrimet dhe adresat e anëtarëve sindikal;</p> <p>1.4. Dokumentin për emërtimin e konfederatës, i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me konfederatat sindikale të regjistruara më parë në MPMS, selinë dhe logon e konfederatës;</p> <p>1.5. Dokumentin për numrin dhe përqindjen e anëtarëve sindikal të</p>	<p>1. The trade union confederation on the occasion of the application to register in MLSW, in addition to the written request, must also present this documentation:</p> <p>1.1. Statute of the confederation;</p> <p>1.2. Minutes of the confederate congress meeting;</p> <p>1.3. Register of all current members of the confederation, including name and surname, birthday, ID number, signatures and addresses of union members;</p> <p>1.4. The document for the name of the confederation, which should not be the same as the trade union confederations previously registered in MLSW, the headquarters and the logo of the confederation;</p> <p>1.5. Document on the number and percentage of trade union members of</p>	<p>1. Sindikalna konfederacija povodom zahteva za registraciju u MRSZ, pored pismenog zahteva, mora da priloži i ovu dokumentaciju:</p> <p>1.1. Statut Konfederacije;</p> <p>1.2. Zapisnik sa sastanka kongresa konfederacije;</p> <p>1.3. Registar svih trenutnih članova Konfederacije, uključujući ime i prezime, rođendan, matični broj, potpise i adrese članova sindikata;</p> <p>1.4. Dokument za naziv konfederacije, koji ne bi trebalo da bude isti kao sindikalne konfederacije prethodno registrovane u MRSZ, uz sedišta i logo federacije;</p> <p>1.5. Dokument o broju i procentu članova sindikata udruženih u sindikalnu konfederaciju;</p>

<p>federatave sindikale të bashkuara në konfederatën sindikale;</p> <p>1.6. Deklaratat për anëtarësim të anëtarëve sindikal në konfederatë;</p> <p>1.7. Të dhënat e sakta për udhëheqjen e konfederatës sindikale, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, telefonit dhe nënshkrimet e anëtarëve të udhëheqjes sindikale;</p> <p>1.8. Vendimin për bashkimin e federatave sindikale në konfederatë sindikale.</p> <p>2. Anëtari i një konfederate sindikale nuk mund të jetë edhe anëtar i një konfederate tjetër sindikale.</p> <p>3. Në rast se ekziston një konfederatë e regjistruar më parë, konfederata që aplikon për regjistrim duhet të prezantojë deklaratat për ç'anëtarësim të anëtarëve që kanë qenë anëtarë në konfederatën paraprake dhe deklaratat për anëtarësim në konfederatën e re.</p>	<p>trade unions united in the trade union confederation;</p> <p>1.6. Declarations for membership of trade union members in the confederation;</p> <p>1.7. Accurate data on the leadership of the trade union confederation, including name and surname, birthday, ID number, telephone number and signatures of members of the trade union leadership;</p> <p>1.8. The decision to unite the trade union federations into a trade union confederation.</p> <p>2. A member of a trade union confederation may not be a member of another trade union confederation.</p> <p>3. If there is a previously registered confederation, the confederation applying for registration shall submit the declarations for non-membership of the members who were members of the previous confederation and the declarations for membership in the new confederation.</p>	<p>1.6. Izjave o članstvu članova sindikata u konfederaciji;</p> <p>1.7. Tačni podaci o rukovodstvu sindikalne konfederacije, uključujući ime i prezime, rođendan, matični broj, broj telefona i potpise članova sindikalnog rukovodstva;</p> <p>1.8. Odluka o udruživanju sindikalnih federacija u sindikalnu konfederaciju.</p> <p>2. Član sindikalne konfederacije ne može biti član druge sindikalne konfederacije.</p> <p>3. Ukoliko postoji prethodno registrovana konfederacija, konfederacija koja se prijavljuje za registraciju podnosi izjave o nečlanstvu članova koji su bili članovi prethodne konfederacije i izjave o članstvu u novoj konfederaciji.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Ndryshimi i emrit dhe udhëheqjes</b> <b>sindikale të shoqatave</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Changing the name and union</b> <b>leadership of the associations</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Promena imena i sindikalnog vodstva</b> <b>udruženja</b></p>
<p>1. Shoqata sindikale e regjistruar më parë në MPMS, mund të kërkojë nga organi përgjegjës i Ministrisë, ndryshimin e emrit dhe konfirmimin e udhëheqjes së re sindikale dhe kalimin e shoqatave në federatë tjetër.</p> <p>2. Për ndryshimin e emrit, konfirmimin e udhëheqjes së re sindikale dhe kalimin e shoqatave në federatë tjetër, krahas kërkesës me shkrim, shoqata duhet të dorëzojë edhe këto dokumente:</p> <p>2.1. Procesverbalin e organit kompetent të shoqatës të paraparë me statut të shoqatës, në të cilin kanë marrë pjesë së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të kuvendit, duke përfshirë emrin, mbiemrin, numrin e letërnjoftimit dhe nënshkrimet;</p> <p>2.2. Vendimin e organit të shoqatës sindikale për zgjedhjen dhe emërimin e udhëheqjes së re sindikale dhe ndryshimin e emërtimit të shoqatës sindikale.</p>	<p>1. The trade union association previously registered in MLSW, may request from the responsible body of the Ministry, the change of name and confirmation of the new trade union leadership and the transfer of the associations to another federation.</p> <p>2. For the change of the name, the confirmation of the new union leadership and the transfer of the associations to another federation, in addition to the written request, the association must also submit the following documents:</p> <p>2.1. Prcesverbal of the competent body of the association provided by the statute of the association, which was attended by at least two thirds (2/3) of the members of the assembly, including name, surname, ID number and signatures;</p> <p>2.2. The decision of the body of the trade union association for the election and appointment of the new trade union leadership and the change of the name of the trade union association.</p>	<p>1. Sindikalno udruženje prethodno registrovano u MRSZ, može zahtevati od nadležnog tela Ministarstva promenu imena i potvrdu novog rukovodstva sindikata i prenos udruženja u drugu Federaciju.</p> <p>2. Za promenu imena, potvrdu novog rukovodstva sindikata i prenos udruženja u drugu Federaciju, pored pismenog zahteva, udruženje mora dostaviti i sledeće dokumente:</p> <p>2.1. Zapisnik nadležnog organa udruženja predviđeni statutom udruženja, u kojima je učestvovalo najmanje dve trećine (2/3) članova, skupštine uključujući ime, prezime, matični broj ID i potpise;</p> <p>2.2. Odluku organa sindikalnog udruženja za izbor i imenovanje novog sindikalnog rukovodstva i promena naziva sindikalnog udruženja.</p>

